



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 67 Prot.

Vau Dejës, me 08 01 .2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” neni 53 pika 3 germa a, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se zhvillohet mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejës ditën e Hëne me datë 15.01.2024 ora 14:00 Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

Me këtë rend dite:

1. Projekt vendim për miratimin e listes së kërkuesve për programin e strehimit social “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme “ (Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pa favorizuar).

Komisioni i këshillit do mblidhet ditën e premte, datë 12.01.2024 ora 09.00.

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Znj. Albina Livadhi, Znj. Meliha Zyberaj, Znj. Paola Pleshaj

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj





KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS
PROCES VERBAL

Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejës 15.01.2024,

Data 15.01.2024, ora 14:00. Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Nj.Ad. Bushat.

Rendi i dites:

1. Projekt vendim për miratimin e listës së kërkuesve për programin e strehimit social “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme” (Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pa favorizuar).

Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejes e kërkuar nga Kryetari Bashkisë Z. Kristian Shkreli. Mbledhja u zhvillua me datë 15.01.2024 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z. Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 23 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z. Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 23 vota Pro.**

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z. Edmond Gjeçaj-specialist i sektorit të strehimit i cili shpjegon për këshilltarët se komisioni i strehimit ka ndjekur procedurat e vlerësimit të kërkesave sipas ligjit dhe akteve nën ligjore në dy faza, dhe në mbledhjen përfundimtare të tijë ky komision ka bërë vlerësimin e të gjithë dokumentacionit që kanë paraqitur banorët nga ku zyra e strehimit social ka hartuar listen përfundimtare të banorëve kërkues të cilët plotësojnë kriteret sipas ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar. Gjithashtu për vlerësimin e listës së kërkuesve që plotësojnë kriteret është përdorur edhe sistemi i pikëzimit i miratuar me VKB nr.81/2023. Janë përfitues 24 familje.

Z. Gjon Marku-këshilltarë pyet: A ka faturë zbatimi i këtij programi sepse vërej se janë përjashtuar nga lista e fazës së parë dy familje, Marije Bacaj dhe Paulin Bisha, arsyeja pse?

Z. Edmond Gjeçaj përgjigjet: Për Znj. Marije Bacaj, komisioni e ka skualifikuar sepse kjo është jashtë shteti dhe nuk ka plotësuar deklaratën, ndërsa për Z. Paulin Bisha nuk mund të përfshihet në këtë skemë sepse nuk ka fond sepse shtëpia e tij duhet ndërtuar nga themeli.

Z. Gjon Marku-këshilltarë: Unë propozoj që të votohet propozimi i kësaj liste me dy familjet e lartpërmendura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ermir Tahiri pyet: A mund të perfshihen ne listen fituese keto dy familje?

z. Edmond Gjeçaj:Fondi eshte i plotesuar me listen qe ju kemi paraqitur.

Z.Mark Bisha-këshilltarë: Me ke eshte konsultuar komisioni qe ka bere verifikimin e shtepise se Znj, Marije Bacaj sepse ky person vertet qe eshte jashte shteti por shtepia eshte po aty.

Z.Edmon Gjeçaj pergjigjet: Komisioni ka komunikuar me kryetarin e fshatit dhe ligjerisht duhet te jete familjari prezent gjate verifikimit.

Z.Mark Bisha nderhyn duke deklaruar se komisioni eshte i detyruar te shkoje disa here per te verifikuar familjet ne nevoje sepse ky komision paguhet nga taksat tona dhe nuk duhet te mjaftohet vetem duke shkuar dy here per verifikim,

Z.Marin Mardoda-këshilltare pyet: Sa kohë kemi që të perfshihen edhe keto dy familje ne kete liste sepse mesa shikoj unë, Znj.Marije Bacaj skualifikohet vetem sepse nuk ka qene prezent ne kohen kur ka shkuar komisioni per vertifikim, ndersa per Z.Paulin Bisha nuk paska fond por a eshte e mundur qe ketij ti jepet aq sa i takon,pra ti jepet vlere jo per ndertimin e tere shtepise por aq sa i takon ne raport me te tjeret ?

Z.Edmond Gjeçaj pergjigjet : Bashkengjitur projekt vendimit keni nje liste emerore te aplikuesve per fazen e dytë te projektit ku jane te perfshire edhe keto dy familje qe po permenden.

Z. Frano Prenga pyet: A ka ndonje rruge ligjore per familjet qe jane perjashtuar nga aplikimi te jene fitues ne fazat e tjera meqë nuk kane AMTP?

Z.Edmond Gjeçaj pergjigjet: AMTP eshte kriter ligjor dhe duhet qe ta kene aplikuesit.

Për Znj.Marije Bacaj mund te aplikojë për fazen e dytë ndersa per Z.Paulin Bisha banesa rezulton si rikonstrukcion qe e kalon vleren e investimit.

Pasi këshilltarët nuk kishin pyetje të tjera Z Ervis Shimaj e hedh ne votim këtë pikë të rendit të ditës.

Moren pjesë në votim 20 këshilltarë;

17 vota PRO

3 vota Kundra (Z. Gjon Marku, Florian Tanushi, Marin Dodaj)

Abstenim asnjë votë.

3 këshilltarë nuk moren pjesë në votim: Z.Mark Bisha, Z. Martin Mardoda, Znj. Leonora Prenga.

Projekt vendimi Miratohet me 17 vota PRO.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e datës 15.01.2024 deklarohet e mbyllur nga kryetari këshillit.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA

Këshilltarët:

Evis Shiuq
Frano Pirepa
Kristjana Kavochi
Emir Tshiri
Jovanjo Kula
Onela Lleshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Listë prezenca e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës për mbledhjen jashtë rradhe 15.01.2024.

Nr.	Emër	Mbiemër	Prezenca
1	Marin	Dodaj	
2	Gjovana	Corri	
3	Pjeter	Lleshi	
4	Rregjinë	Shelqetja	
5	Florin	Tanushi	
6	Vijoleta	Markolaj	
7	Ferdinand	Fusha	
8	Mark	Bisha	
9	Paola	Pleshaj	
10	Afrim	Kapidanja	
11	Franga	Kola	
12	Kastriot	Shkjau	
13	Leonora	Prenga	
14	Neki	Kapllanaj	
15	Arsen	Mehmeti	
16	Roberto	Trushi	Roberto Trushi
17	Frano	Prenga	
18	Albina	Livadhi	
19	Ervis	Shimaj	
20	Kristjana	Kovaçi	
21	Rita	Preçi	
22	Aleko	Dodani	
23	Vjollcë	Zagani	
24	Martin	Mardoda	
25	Mirela	Vasija	
26	Ermir	Tahiri	
27	Ornela	Lleshi	
28	Besmir	Kapaj	
29	Gjon	Marku	
30	Meliha	Zyberaj	
31	Samed	Hasmegaj	

SEKRETARI KËSHILLIT

ARDIAN ÇELEPIJA

